



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Rektori
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 2550/21; Datë:10.09.2021

Në bazë të nenit 48 paragrafi 1.4 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 10.09.2021, merr

V E N D I M

I.

Miratohet Rregullorja për Hulumtime Shkencore.

II.

Rregullorja hynë në fuqi nga dita e miratimit të saj.

A r s y e t i m

Senati i UShAF për qëllim të harmonizimit të rregulloreve me Statutin e UShAF pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF;
2. Njësive akademike të UShAF;
3. Arkivit të UShAF;

Rektori
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI



Në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-135 të Republikës së Kosovës për Veprimtari Kërkimore- shkencore dhe nenit 48 paragrafi 1.4 të Statutit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF-it, në mbledhjen e mbajtur me 10.09.2021, miraton:

RREGULLORE PËR HULUMTIME SHKENCORE

Dispozitat e përgjithshme Neni 1

Me Rregulloren për hulumtime shkencore (në tekstin e mëtejme: " Rregullore") në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: "Universiteti"), përkufizohen rregullat, procedurat dhe dokumentet e tjera shoqëruese për organizmin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të stafit akademik, hulumtues dhe studentëve konform Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: "Statuti").

Në mënyrë specifike, me këtë Rregullore rregullohen:

1. Aktivitetet e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe aplikative në Universitet;
2. Organizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe aplikative;
3. Të drejtat dhe detyrimet e organeve të universitetit dhe stafit akademik dhe hulumtues si dhe studentëve pjesëmarrës në punët kërkimore-shkencore;
4. Përgjegjësitë e zyrës për mbështetjen e kërkimeve shkencore dhe aplikative;
5. Veprimtaria hulumtuese;
6. Komisioni për hulumtime dhe shkencë;
7. Financimi i punës kërkimore-shkencore dhe aplikative;
8. Procedurat e aplikimit për mbështetje të aktivitete hulumtuese;
9. Procedura e rimbursimit të pagesave për publikime në revista dhe konferenca;
10. Procedura e aplikimit për mbështetje për pjesëmarrje në konferenca shkencore.

Neni 2

Universiteti bënë kërkime shkencore, punë artistike dhe aplikative me qëllime të:

1. Zhvillimit të vazhdueshëm të procesit arsimor;
2. Përafrimit të studentëve me kërkimet shkencore dhe me punën artistike;
3. Vazhdimin të zhvillimit shkencor - profesional dhe artistik të mësimdhënësve;
4. Zgjidhjes së problemeve të industrisë.

Aktivitetet e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe aplikative

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe aplikative sipas kësaj Rregulloreje përfshinë punën kërkimore-shkencore dhe aplikative, publikimin e rezultateve të punës, aftësimin e kuadrit për punë kërkimore shkencore si dhe ngritjen profesionale të personelit akademik, shkencor dhe studentëve.

Neni 3

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe aplikative

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe aplikative përfshinë hulumtimet fundamentale të shkencore dhe të aplikuara në përputhje me Ligjin nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore-shkencore.

Neni 4

Veprimtaria Kërkimore-shkencore dhe aplikative është e bazuar në: lirinë dhe autonominë krijuese; konkurrencës së programeve dhe projekteve shkencore; aplikimit të standardeve ndërkombëtare të kualitetit në lëminë e shkencës; publikimit të rezultateve të punëve të kryera të cilat i nënshtrohen kritikës shkencore e profesionale; etikës; bashkëpunimit të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare nga lëmi i shkencës dhe hulumtimit të ndërlidhura me sistemin e arsimit të lartë në inkurajimin dhe vlerësimin e përmbajtjeve specifike nacionale.

Neni 5

Veprimtarinë Kërkimore-shkencore dhe aplikative në universitet kryen në Insititutin e Shkencave të Aplikuara (në tekstin e mëtejshëm: "Instituti").



Neni 6

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe aplikative përfshinë aktivitetet si në vijim:

- Realizimin e hulumtimeve shkencore themelore, të avancuara dhe aplikative me qëllim të avancimit të hulumtimit shkencor dhe aplikimit të tij në fushat në të cilat vepron Universiteti.
- Organizimi i konferencave shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare; të punëtorive dhe seminareve; hulumtimet shkencore dhe bashkëpunimin me institucionet tjera hulumtuese në vend dhe jashtë;
- Bashkëpunimet me ndërmarrjet ekonomike dhe industrinë;
- Përgatitjen e studimeve dhe analizave laboratorike në fushat me të cilët merret Universiteti;
- Përgatitja e ekspertizës dhe kontrolli i cilësisë së produkteve dhe përshtatshmërië së përdorimit të tyre;
- Organizimi i seminareve për zhvillimin profesional të stafit akademik në lëmit shkencore relevante për Universitet;
- Veprimtarive tjera hulumtuese - shkencore në fushat që mbulohen me programet studimore në Universitet.

Neni 7

Në përputhje me Statutin e Universitetit, Prorektori për mësim, shkencë dhe çështje studentore në bashkëpunim me Zyrën për mbështetjen e hulumtime dhe kërkime shkencore janë përgjegjës për:

- Udhëheqjen e aktiviteteve të hulumtimit në Universitet në pajtim me misionin dhe planin strategjik;
- Bashkëpunimin ndërkombëtar shkencor;
- Hartimin e planit vjetor të Universitetit për punë kërkimore-shkencore së bashku me buxhetin vjetor për hulumtim shkencor;
- Ndarjen e mjeteve të nevojshme për realizimin e veprimtarisë hulumtuese;
- Koordinimin dhe prioritetet e planit dhe aktiviteteve të propozuara hulumtuese shkencore .

Neni 8

Zyra për mbështetjen e kërkimeve shkencore

Veprimtaria hulumtuese në Universitet koordinohet nga Zyra për mbështetjen e kërkimeve shkencore dhe Prorektori për mësim, shkencë dhe çështje studentore.

Zyra për mbështetjen e kërkimeve shkencore është përgjegjëse për:

- Organizimin e konferencave, punëtorive, seminareve apo forumeve shkencore;
- Botimin e revistave shkencore;

- Përkrahjen e zhvillimit shkencor të stafit akademik;
- Koordinimin dhe monitorimin e projekteve hulumtuese;
- Përkrahjen e aplikimeve për projekte hulumtuese të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare;
- Mirëmbajtjen dhe përditësimin e seksionit për hulumtim të Web faqes së Universitetit dhe portalit të brendshëm të shkëmbimit të informacionit dhe dokumenteve, USHARE;
- Koordinimin e bazës së të dhënave për hulumtim;

Menaxhimin dhe organizimin e shpërblimit “Hulumtuesi më imirëi vitit”.

Neni 9

Përgjegjësitë e stafit akademik

Secili mësimdhënës në Universitet, është i obliguar që të publikoj aktivitetet e tyre shkencore në revista ndërkombëtare dhe atë mesatarisht nga një punim në vit në tri vitet e fundit. Publikimet duhet të bëhen në revistat individuale dhe ato të indeksuara në platformat të cilat i aprovon Senati i Universitetit. Stafi akademik është përgjegjës për aktivitetet individuale kërkimore-shkencore dhe aplikative dhe për të arriturat e tyre janë të obliguar të njoftojnë zyrën për mbështetjen e kërkimeve shkencore dhe të raportojnë në Këshillin Mësimorë/Shkencor.

Neni 10

Në nivel të njësive akademike përgjegjës për aktivitetet kërkimor-shkencore dhe aplikative janë dekanët e njësive akademike dhe Këshilli Mësimor/Shkencor i Universitetit.

Neni 11

Komisioni për hulumtime dhe shkencë

Komisioni për hulumtim dhe shkencë është organi përgjegjës për menaxhimin dhe përkrahjen e aktiviteteve hulumtuese në Universitet dhe përbëhet nga:

- Prorektori për mësim, shkencë dhe çështje studentore (kryesues),
- Tre anëtar të stafit akademik me thirrje të profesor asistent dhe më lartë, me përvojë të dëshmuar në fushën e hulumtimeve shkencore,
- Një përfaqësues i studentëve i deleguar nga Parlamenti studentor i Universitetit
- Zyrtari i për mbështetjen e kërkimeve shkencore.

Prorektori për mësim, shkencë dhe çështje studentore në bashkëpunim me zyrën për mbështetjen e kërkimeve shkencore është përgjegjës për veprimtaritë botuese të Universitetit: revistën shkencore dhe publikimet tjera.

Neni 12

Detyrat e Komisionit për hulumtime dhe shkencë

Komisioni për hulumtime dhe shkencë ka këto detyra:

- Propozoj Senatit revistat individuale dhe plantformat (databazat) e revistave shkencore për publikimet e stafit akademik
- Propozoj Senatit ndryshimet në Rregullorën e hulumtimeve shkencore
- Aprovoj apo refuzoj kërkesat për përkrahje të aktiviteteve shkencore të stafit akademik
- Aprovoj apo refuzoj mbulimin e shpenzimeve të botimit të punimeve shkencore të stafiti akademi në revista shkencore ndërkombëtare
- Aprovoj apo refuzoj kërkesat a stafit akademik për mbulimin e pjesëmarrjes në konferenca, simpoziume, punëtori apo forume shkencore ndërkombëtre
- Organizimin e konferencave, simpoziumeve, punëtorive po forumeve shkencore në Universitet

Neni 13

Hulumtuesi i vitit

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore-shkencore, hulumtuesi më i mirë mund të stimulohet deri 50% nga paga mujore të tyre.

Senati çdo vit shpall konkursin për Hulumtuesin e vitit në Universitet dhe vendos kriteret të cilat duhet të plotësohen për të konkuruar për Hulumtuesin e vitit. Komisioni për hulumtime dhe shkencë bënë analizën e të gjitha aplikacioneve dhe përzgjedh kandidatin të cilin ja propozon senatit për aprovim. Senati në mbledhjen e parë e bënë shpalljen e Hulumtuesit të vitit.

Neni 14

Financimi i punës kërkimor-shkencore

Financimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore bëhet nga buxheti i Universitetit për kërkime shkencore si dhe nga pjesëmarrja e partnerëve dhe donatorëve të jashtëm bashkëpjesëmarrës në projekte të përbashkëta.

Nga buxheti për hulumtime shkencore mbulohen:

- Projektet hulumtuese të njësive akademike;
- Pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare;
- Botimi i punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare;
- Shpenzimet për bashkëfinancim për pjesëmarrje në projekte hulumtuese rajonale dhe ndërkombëtare, etj.

Lartësia e mjeteve financiare për veprimtari kërkimore-shkencore caktohet me buxhetin e Universitetit, të miratuar nga Këshilli Drejtues.



Neni 15

Procedura e rimbursimit të pagesave për publikime

Punimet të cilat e kanë kaluar me sukses procesin e publikimit të tyre, Autori e dërgon kërkesën për rimbursim pranë Komisionit për hulumtime dhe shkencë. Kërkesa për rimbursim dorëzohet jo më vonë se 30 ditë nga dita e botimit në Komisionin për hulumtime dhe shkencë për miratim financiar brenda kornizës buxhetore dhe vendimi i dërgohet autorit brenda 30 ditëve nga dorëzimi i kërkesës.s

Për kërkesat e miratuara pas mbylljes së vitit fiskal në sistemin e pagesave (Sistemi i Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës) rimbursimi do të procedohet në vitin fiskal vijues.

Neni 16

Procedura e aplikimit për pjesëmarrje në konferenca shkencore.

Stafi akademik i cili shpreh interesim të merrë pjese në ndonjë konference, simpozium, punëtori apo kongres të karakterit shkencor duhet të beje kërkesë pranë Komisioni për hulumtim dhe shkencë për aprovim paraprak. Vetëm aplikacionet të cilat janë paraprakisht të aprovuara mund të rimbursohen nga Universiteti.

Neni 17

Procedurat e aplikimit për përkrahjen e aktiviteteve hulumtuese;

Prorektori për mësim, shkencë dhe çështje studentore udhëheq me fondin për publikime dhe mund të alokojë mjetet e lejueshme për publikime brenda vitit fiskal, të parapara nga planifikimi buxhetor i Universitetit.

Zyra për mbështetjen e kërkimeve shkencore në bashkëpunim me prorektorin për mësim, i jep përkrahje administrative dhe menaxheriale fondit për publikime.

Komisioni për hulumtime aprovon kërkesat për financim të teksteve universitare.

Neni 18

Dispozitat përfundimtare

1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në mënyrë të njëjtë me dispozitat për miratimin e saj.
2. Kjo Rregullore hynë në fuqi nga dita e miratimit në Senat.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja për hulumtime shkencore nr 45/20 e datës 09.01.2020

Kryesues i Senatit të UShAF,
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI, Rektor

